

# 1989

## Rishikimi i qytetit Para dhe pas



# 1989

## Before & After The city revisited



MUZEUL  
MUNICIPIULUI  
BUCURESTI



25 Tetor - 27 Nëntor 2022  
October 25<sup>th</sup> - November 27<sup>th</sup>  
Universiteti "Fan S. Noli"  
"Fan S. Noli" University  
Korçë, Albania

Vitet e regjimit komunist dhe vitet që pasuan përshkruhen në libra dhe kujtime, me etapa të përcaktuara qartë. Ajo që mbijeton nga një regjim në tjetrin, për njerëzit, mbetet e paqartë. Për disa, ata më të moshuarit, mbetet një nostalgji, për të tjerët, më të rinjtë, një rrënim sentimental. Për ata që nuk e njohin, që kanë lindur pas një pragu historik dhe që jetojnë vetëm realitetet e reja, mbetet rreziku i kthimit mbrapa, në vend të ndjeshmërisë përballë bërjes, evolucionit.

Mbetet sfida e kapjes së detajeve të ndryshimit përmes përvojës së një të mbijetuarit -një dëshmitar që i ruajti këto ndryshime në kujtesën e tij fotografike, duke i bashkangjitur momentet e jetës së tij me kujtesën kolektive dhe pas vitit 1989 ndoqi të njëjtin pasion për dekada. Është me ndihmën e këtij dëshmitari që ky rrëfim i shkurtër u krijua dhe ne mund të përdorim fotografitë e tij. Ai quhet Andrei Bîrsan.

Rasti i studimit është Bukureshti, pasi Andrei ka jetuar në këtë qytet për gjithë jetën. Familja e tij vazhdon ta eksplorojë këtë qytet profesionalisht. Për ne që ishim 20 ose 25 vjeç në 1989, realitetet e sotme ishin të paimagjinueshme atëherë, si në aspektin e lirisë së shprehjes publike apo profesionale ashtu dhe të stilit të jetesës të ndryshuar nga teknologjia dhe përmirësimi i komoditetit të përditshëm të sjellë nga rritja e standardeve të jetesës. Janë dy botë të ndryshme që u ndanë në vitin 1989. Jo të gjithë ia dolën mbanë në këtë ndarje, pasi ka breza që nuk e kanë marrë veten kurrë, as në aspektin profesional dhe as në atë shoqëror. Ka nga ata që janë kapur në 40 apo 45 vitet e këtij ndryshimi të 1989-ës. Ata nuk mund të përshtateshin. Ata janë pensionistët e sotëm, nostalgjikë për kohën e nënshtrimit në këmbim të paqes.

Nga fotografitë shihet lehtësisht imazhi i ndryshimit rrënjësor të përditshmërisë urbane të 30 viteve të fundit, me të njëjtat vende, por me një notë ndryshe të sjelljes kolektive. Liri do të thotë të marrësh përgjegjësi në çdo moshë, ndërsa nënshtrimi në këmbim të lirisë do të thotë që Partia të marrë përgjegjësinë për ty. Ajo që po shohim sot është rezultat i marrjes së përgjegjësisë nga individët dhe komunitetet e vogla: qytetet, rajonet apo komunitetet lokale, degët profesionale, nëpërmjet drejtuesve të tyre.




Foto / Photo credit: Andrei Bîrsan

Rishikimi i qytetit, para dhe pas një viti ose pragu historik të caktuar, mund të jetë një metodë e dobishme krahasuese jo vetëm për studimin historik dhe antropologjik, por veçanërisht për përcaktimin dhe kuptimin e proceseve që ndodhin brenda natyrës njerëzore, që është gjithmonë në kërkim të përparimit, rehatisë së përditshme, sigurisë personale dhe asaj profesionale.



The years of the communist regime and the years that followed are described in books and memoirs, with clearly defined stages. What survives from one regime to the next, from the human condition, remains unclear. For some, those older, a nostalgia, for others, younger, a sentimental wreck. For the unfamiliar, those born after a historical threshold, and living only the new realities, there remains the danger of regression, instead of empathy in the face of becoming, of evolution.

There remains the challenge of capturing the detail of change through the experience of a survivor – a witness who preserved these changes in his photographic memory, attaching his life moments to the collective memory and continuing to pursue the same passion for decades after 1989. It is with the help of such a witness that this short narrative is created and we make use of his photographs. His name is Andrei Bîrsan.

Bucharest is the case study, as Andrei has always lived in this city. His family continues to explore this city professionally. For those of us approaching 20 or 25 years old in 1989, the realities of today were unconceivable then, both in terms of freedom of the public or professional expression and the lifestyle modified by technology and the improvement of daily comfort brought about by increased living standards. They are two different worlds that separated in 1989. Not everyone has succeeded in this separation, as there are generations that have never recovered, neither professionally nor socially. There are those who have been caught up in the 40 or 45 years of this 1989 change. They couldn't adapt. They are today's retirees, nostalgic for the times of submission in exchange for peace.

From the photographs, the image of the radical change of the urban everyday life for the last 30 years is easily seen, with the same places, but in a different note of collective behavior. Freedom means taking responsibility with each age, while submission in exchange for freedom means the Party taking responsibility for you. What we are seeing today is the result of the assumption of responsibility by individuals and small communities: cities, regions or local communities, professional branches, through their leaders.

The city revisited, before and after a certain year or historical threshold, can be a useful comparative method not only for historical and anthropological study, but especially for defining and understanding the processes at work within human nature, perpetually longing for progress, daily comfort, personal and professional security.

*Adrian Majuru*



**Kurator / Curator: Dr. Adrian Majuru** - Menaxher/ Manager  
Muzeu i Komunës së Bukureshtit / Bucharest Municipality Museum

**Foto / Photo credit: Andrei Bîrsan**

**Përkthimi dhe përshtatja në shqip / Translation and adaptation into Albanian:**

**Dr. Benita Stavre** - Zv/ Rektor për shkencën dhe projektet  
Deputy / Rector in charge of Research and Projects  
Universiteti "Fan S. Noli"/ "Fan S. Noli" University

**Përkthimi dhe përshtatja në anglisht dhe promovimi / Translation and adaptation into English and promotion:**

**Eliana Radu** - Koordinatore e Departamentit të PR, Marketingut dhe Projekteve Kulturore  
Coordinator of the PR, Marketing and Cultural Projects Department  
Muzeu i Komunës së Bukureshtit / Bucharest Municipality Museum

**Dizajn grafik / Graphic design:**

**Ştefan Csampai** - Redaktor i Muzeut të Komunës së Bukureshtit / Editor Bucharest Municipality Museum